VENDIM
Nr. 22, datë 4.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 4.4.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 38 (A) 2023, që u përket:

KËRKUES: AHMET JANGULLI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve penale për "disponimin ndëshkues ndaj avokatit", nr. 115, datë 9.7.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 638, datë 5.7.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-649, datë 18.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 17, 42, 116, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Më datë 26.7.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër (*Prokuroria Dibër*), mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A.B. dhe materialeve referuese nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, ka regjistruar procedimin penal nr. 359 për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të disa punonjësve të Bashkisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë (ZRPP). Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria Dibër i ka kërkuar gjykatës, në mbështetje të nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), pushimin e këtij procedimi penal, pasi në veprimet e punonjësve të Bashkisë dhe të ZRPP-së, Bulqizë nuk janë konstatuar elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër në seancën gjyqësore të datës 6.7.2021 ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes penale, në të cilën ka qenë i pranishëm edhe kallëzuesi

A.B., i cili, me prokurën e posaçme të datës 21.4.2021 dhe me deklarim në seancë, ka zgjedhur të përfaqësohet nga avokati Ahmet Jangulli (*kërkuesi*). Gjatë kësaj seance gjyqësore prokurori i çështjes ka paraqitur kërkesë paraprake për praninë e konfliktit të interesit mes kallëzuesit dhe mbrojtësit të tij, avokatit Ahmet Jangulli, pasi ky i fundit ka ushtruar më parë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe ka gjykuar një çështje civile me objekt pushimin e cenimit të pronësisë, ku kallëzuesi A.B. ka qenë në pozitën e të padituritit, për të cilën ka disponuar me vendimin nr. 75, datë 10.12.2007, pjesë e arsyetimit të të cilit është përfshirë në fashikullin e procedimit penal.

3. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 6.7.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorisë dhe të përjashtojë kërkuesin nga përfaqësimi i kallëzuesit A.B., duke i bërë me dije kallëzuesit se ky avokat nuk mund të mbronte të drejtat e tij në këtë proces dhe duke i kërkuar të largohej nga salla e gjyqit. Gjykata i ka bërë me dije kallëzuesit edhe të drejtën për kundërshtimin e këtij vendimi së bashku me vendimin përfundimtar të themelit të çështjes.

4. Pas përfundimit të kësaj seance gjyqësore, kërkuesi Ahmet Jangulli ka paraqitur kërkesë në emër të kallëzuesit A.B., e cila është nënshkruar vetëm nga kërkuesi, për përjashtimin e gjyqtares N.K., duke pretenduar se ajo ka paragjykuar çështjen. Kërkesa është regjistruar më datë 8.7.2021. Me vendimin nr. 115, datë 9.7.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur mospranimin e saj, për shkak se kërkesa është paraqitur nga personi që nuk i përket e drejta, si dhe, bazuar në nenin 22/a të KPP-së, dënimin e kërkuesit me gjobë në vlerën 10,000 lekë për abuzim me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit. Sipas dispozitivit të vendimit, kundër tij lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar.

5. Kallëzuesi A.B., nëpërmjet avokatit Ahmet Jangulli, ka paraqitur ankim ndaj vendimit të mësipërm, duke kërkuar ndryshimin e tij, si dhe heqjen e masës ndëshkuese me gjobë dhe të shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të avokatit. Në ankim është pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur rregullat procedurale, pasi nuk ka vijuar seancën aty ku ishte ndërprerë, por ka lejuar paraqitjen e kërkesës paraprake nga prokuroria për përjashtimin e avokatit, kërkesë që ishte e pabazuar në ligj.

6. Ndërsa ankimi ishte në pritje të shqyrtohej në Gjykatën e Apelit Tiranë, më datë 4.11.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 115, datë 9.7.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 159, datë 23.12.2021, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në vlerësimin e Kolegjit të Gjykatës kërkuesit i është caktuar gjobë në cilësinë e përfaqësuesit të palës ndërgjyqëse dhe kjo e fundit i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj gjatë gjykimit të çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përpara se t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual për cenimin eventual të së drejtës së mbrojtjes nga dënimi me gjobë i përfaqësuesit ligjor. Ndërsa në lidhje me gjobën e vendosur, Kolegji u shpreh se neni 22/a i KPP-së parashikon caktimin e gjobës si një mjet të ri për disiplinimin e procesit gjyqësor, me qëllim shmangien e abuzimeve me të drejtat në procesin gjyqësor dhe që i kundërdrejtohet palës ose përfaqësuesit të saj, kur me vetëdije paraqesin kërkesa ose pretendime abuzive. Prandaj, Kolegji theksoi se gjoba e caktuar, në dallim nga gjoba administrative, ka regjim juridik të ndryshëm, pasi normohet nga një kuadër tjetër ligjor, jepet nga një organ gjyqësor dhe jo administrativ, si dhe ka për qëllim zhvillimin e procesit gjyqësor të themelit pa abuzim nga palët ndërgjyqëse.

7. Në vijim, në lidhje me ankimin ndaj vendimit nr. 115, datë 9.7.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për mospranimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit dhe caktimin e gjobës, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 638, datë 5.7.2022, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk mund të ankimohet me ankim të veçantë, por vetëm së bashku me vendimin përfundimtar. Sipas asaj gjykate, çështja penale, e cila gjykohet me trup gjykues monokratik të përbërë nga gjyqtarja e seancës paraprake për të cilën është kërkuar përjashtimi, në momentin që është ushtruar ankim ndaj vendimit për mospranimin e kërkesës për përjashtim ka qenë në shqyrtim e sipër dhe ende e papërfunduar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se ankimi i veçantë është paraqitur vetëm ndaj vendimit

nr. 115, datë 9.7.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërkohë që nuk ka pasur një vendim përfundimtar për themelin e çështjes penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kallëzuesi A.B., nëpërmjet avokatit Ahmet Jangulli, duke kërkuar prishjen e tij dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

8. Me vendimin nr. 00-2023-649, datë 18.4.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se vendimi që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit dhe caktimin e gjobës është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim i veçantë, por mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar për themelin e çështjes. Sipas këtij kolegji, ky parashikim është shprehur qartë në fjalinë e dytë të nenit 22, pika 4, të KPP-së në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës për përjashtim. Më tej, Kolegji Penal ka arsyetuar se nga interpretimi literal i nenit 22/a të KPP-së, sanksioni i parashikuar në këtë nen është pjesë e vendimit që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit dhe në interpretim sistematik të tij, e drejta e ankimit e parashikuar në nenin 22, pika 4, të KPP-së, sipas të cilit kundër vendimit të përjashtimit mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, vlen për të gjithë vendimin në tërësi, pra edhe për atë pjesë të tij që përmban parashikimin e sanksionit "gjobë" *(shih paragrafin 21 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

9. Me kërkesën e datës 14.8.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 19.10.2023 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 6.11.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të:

10.1 Së drejtës së aksesit, sepse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është "ndëshkues me natyrë penale" dhe kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e tij nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Cenimi i kësaj të drejte i ka mohuar kërkuesit edhe disa të drejta të tjera, si ajo e jetës, e punës, e arsimit dhe e sigurisë juridike.

10.2 Së drejtës së ankimit, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë pranuar ankim të veçantë ndaj aktit sanksionues me natyrë penale dhe kanë njësuar mbrojtësin me palën.

10.3 Së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve e të kontradiktoritetit, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjykuar çështjen në themel, por *prima facie*, duke mos dëgjuar pretendimet kundrejt fakteve, si dhe nuk i ka referuar ato. Gjyqtarja për të cilën është kërkuar përjashtimi ka bërë pjesë të debatit gjyqësor çfarë ka dashur, duke përjashtuar një sërë kërkimesh të kërkuesit. As Gjykata e Lartë nuk i ka krijuar mundësinë për t'u dëgjuar në lidhje me prapësimet dhe për t'u mbrojtur me armët e duhura.

10.4 Standardit të arsyetimit të vendimit, sepse gjykata e apelit ka deformuar rrethanat faktike, duke e konsideruar të paligjshëm ankimin dhe vendimin e ankimuar si të paankimueshëm. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk është shprehur për pretendimet e trajtuara me hollësi në ankim. Ky standard është cenuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi nuk mjafton listimi pjesor, i veçuar apo i plotë nëse mungon arsyetimi i shkaqeve të rekursit, qoftë edhe në mënyrë të kufizuar. Në rekurs janë parashtruar një sërë çështjesh për njësim, por Gjykata e Lartë nuk i ka referuar dhe as është shprehur për to. Ajo gjykatë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, nuk është shprehur për pretendimet e kërkuesit. Gjykata e Lartë ka cituar nenin 22 të KPP-së, por nuk ka arsyetuar për parashikimin e kësaj norme në raport me nenin 19 të KPP-së, dispozitë e cila mungon në dispozitivin e vendimit. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar se çfarë konsiderohet ankim i veçantë.

10.5 Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi gjykata e apelit, duke arsyetuar se nuk është kompetente për gjykimin e ankimit ndaj gjobës, sepse duhet ta gjykojë së bashku me vendimin përfundimtar të themelit të çështjes, konsiderohet një gjykatë e krijuar pa ligj.

10.6 Parimit të mosdënimit pa ligj, pasi disponimi ndëshkues me natyrë penale është bërë pa ligj, duke cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, të drejtën e një gjykimi të drejtë publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

10.7 Parimit të barazisë para ligjit, sepse gjykatat kanë vendosur një disponim të padëgjuar në jurisprudencën gjyqësore, duke ndëshkuar pa ligj përfaqësuesin e kallëzuesit.

10.8 Parimit të sigurisë juridike, pasi gjykatat kanë krijuar në invers "norma juridike të reja" për marrëdhëniet palë/përfaqësues, duke cenuar të drejtën e përfaqësuesit me prokurë për të mbrojtur, nëpërmjet institutit të përfaqësimit, palën në procesin gjyqësor.

11. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

11.1 Vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi nuk është përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Kërkuesi nuk ka identifikuar dhe shfrytëzuar drejt mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesave të tij gjatë ankimit të vendimit që ka cenuar të drejtat e tij. Nga interpretimi literal i nenit 22/a të KPP-së, kjo dispozitë ligjore nuk parashikon që subjekt i këtij sanksioni është avokati mbrojtës i palës ndërgjyqëse, por është vetë pala, ndryshe nga sa është disponuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, objekt i ankimit kushtetues. Me synim goditjen e këtij disponimi, kërkuesi duhet t'i ishte drejtuar gjykatës me kërkesë për ndreqje vendimi, konform nenit 385 të KPP-së, pasi qartësisht konsiderohet një lapsus i gjykatës konfondimi i subjektit të gjobës. Në këtë mënyrë, kërkuesi jo vetëm që do të mund të veçonte objektin e kërkimit nga disponimi në lidhje me çështjen e themelit të palës, por do të mund të ndiqte në mënyrë të pavarur të gjitha shkallët e ankimit dhe gjykimit. Në kushtet kur kërkuesi mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për ndreqjen e vendimit, të parashikuar nga neni 385 të KPP-së, në gjendjen që janë aktet ai nuk ka shteruar të gjitha mjetet ligjore efektive në dispozicion.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae* të kërkuesit, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka disponuar, përveç rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, edhe dënimin e kërkuesit, në cilësinë e përfaqësuesit të kallëzuesit, me gjobë në vlerën 10,000 lekë. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatat më të larta nga kallëzuesi A.B. dhe ankimet e mëtejshme janë nënshkruar nga kërkuesi Ahmet Jangulli në cilësinë e përfaqësuesit. Duke qenë se për masën e gjobës së caktuar ndaj kërkuesit është disponuar jo me vendim të veçantë, por me vendimin për mospranimin e kërkesës për përjashtim, kërkuesi nuk ka pasur asnjë mundësi që të kundërshtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë masën e dhënë ndaj tij. Prandaj edhe pse kërkuesi nuk është palë ndërgjyqëse në vendimet e kundërshtuara, për sa kohë që ato, ndër të tjera, kanë caktuar nominalisht ndaj tij, si përfaqësues i kallëzuesit, një gjobë në vlerë 10,000 lekë, e cila përbën edhe objekt të ankimit kushtetues individual të kërkuesit, konsiderohet se ai justifikon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen

e parashtruar ndaj legjitimohet *ratione personae* në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës.

14. Një tjetër kriter që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi vendimet e kundërshtuara nuk janë përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe se nuk ka identifikuar dhe shfrytëzuar drejt mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesave të tij. Po sipas Prokurorisë së Përgjithshme, me synim goditjen e këtij disponimi, kërkuesi duhet t'i ishte drejtuar gjykatës me kërkesë për ndreqje vendimi, në përputhje me nenin 385 të KPP-së, pasi qartësisht konsiderohet një lapsus i gjykatës konfondimi i subjektit të gjobës. Sipas këtij subjekti, kërkuesi jo vetëm që do të mund të veçonte objektin e kërkimit nga disponimi në lidhje me çështjen e themelit të palës, por do të mund të ndiqte në mënyrë të pavarur të gjitha shkallët e ankimit dhe gjykimit.

15. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 23 datë 10.10.2022; nr. 54, datë 24.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll *subsidiar*, që do të thotë se para se t'i drejtohet Gjykatës, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton se kërkuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar përmes ankimit kushtetues individual vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për atë pjesë që ka vendosur dënimin e tij me gjobë në shumën 10,000 lekë, si edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë që nuk kanë pranuar ankimin ndaj vendimit të gjobës, me arsyetimin se ai mund të kundërshtohet vetëm me vendimin e themelit. Prandaj Gjykata, për të vlerësuar përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, vlerëson se në rastin konkret merr rëndësi të përcaktohet nëse vendimet për caktimin e gjobës ndaj avokatit janë përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

17. Gjykata nuk vë në dyshim natyrën e ndërmjetme të vendimit që ka vendosur së bashku me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit edhe caktimin e gjobës, pasi ai nuk zgjidh në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Megjithatë, në kuptim të përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, në jurisprudencën e saj Gjykata, në mënyrë përjashtimore, ka pranuar se mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues edhe vendimet e ndërmjetme, të cilat edhe pse nuk vendosin mbi themelin e çështjes, gjithsesi plotësojnë këto kritere: (i) vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, në vijim, Gjykata do të

analizojë nëse vendimet e kundërshtuara mund të konsiderohen si përfundimtare për efektet e gjykimit kushtetues.

18. Në rastin konkret, edhe pse kërkuesi nuk është palë ndërgjyqëse e procesit të themelit, masa e gjobës është vendosur nga gjykata e shkallës së parë ndaj tij, në cilësinë e përfaqësuesit, dhe jo ndaj kallëzuesit. Prandaj, në drejtim të përmbushjes së kriterit të parë Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit. Gjithashtu, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili së bashku me mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit ka vendosur edhe masën e gjobës ndaj avokatit Ahmet Jangulli, është ankimuar edhe nga kërkuesi dhe më tej kundër vendimit të asaj gjykate është ushtruar edhe rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se përmbushet edhe kriteri i dytë, ai i shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit edhe nga gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur në lidhje me to.

19. Për sa i takon kriterit të tretë, masës së autonomisë së vendimit që ka vendosur gjobën nga procesi i themelit, Gjykata vëren se neni 22 i KPP-së parashikon se kur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit është bërë nga ai që nuk e ka pasur këtë të drejtë, gjykata që shqyrton ankimin e shpall atë të papranueshëm me vendim. Kurse neni 22/a i KPP-së parashikon se vendimi që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit ose që nuk pranon përjashtimin e gjyqtarit përmban shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50,000 lekë në ngarkim të palës që, duke abuzuar, ka parashtruar një kërkesë të padrejtë. Nga ana tjetër, sipas nenit 407 të KPP-së, ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit. Sipas kësaj dispozite, ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre.

20. Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitave të lartpërmendura, e drejta e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm, ashtu si edhe e drejta e ankimit të vendimit përfundimtar u njihet vetëm palëve në proces (palëve ndërgjyqëse), pavarësisht nëse ato veprojnë personalisht ose përmes mbrojtësit të zgjedhur. Në këtë situatë, në kushtet kur kërkuesi nuk është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i ndërmjetëm dhe, për më tepër, nuk është më as përfaqësues ligjor i kallëzuesit, për sa kohë që me vendimin e ndërmjetëm të datës 6.7.2021 gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesën e prokurorit për përjashtimin e tij, ai nuk ka asnjë mundësi që të ankimojë vendimin përfundimtar dhe bashkë me të edhe vendimin e gjobës. Kjo do të thotë se ankimimi i tij në përfundim të procesit gjyqësor është çështje që do të mbetej në vullnetin e kallëzuesit A.B. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka ndonjë garanci që procesi i themelit të mund të riparojë pasojat e vendimit të ndërmjetëm.

21. Në këto kushte, Gjykata çmon se në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar, kërkuesi nuk ka asnjë mjet tjetër në dispozicion për kundërshtimin e vendimit për caktimin e gjobës, që ka disponuar ndaj tij dhe e ka prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj atij nuk mund t'i kërkohet të shterojë mjete që nuk garantojnë efektshmërinë në drejtim të së drejtës së pretenduar të cenuar.

22. Nisur nga sa më lart, për sa kohë që vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit, është kundërshtuar në shkallët më të larta dhe ka një masë autonomie nga procesi i themelit, përjashtimi i tij nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të së drejtës për ankim kushtetues subastancial. Gjykata thekson se gjykatat kanë detyrimin të garantojnë të drejtat kushtetuese individuale, që do të thotë se vendimet për masën e gjobës ndaj kërkuesit duhet të jepen në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor, prandaj ato konsiderohen përfundimtare për efektet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Ndërsa në lidhje me të drejtat kushtetuese të palës ndërgjyqëse, Gjykata, sikurse është shprehur edhe më parë, çmon se kjo e fundit i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj gjatë gjykimit të çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përpara se t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual për të pretenduar edhe cenimin eventual të së drejtës së mbrojtjes nga dënimi me gjobë i përfaqësuesit ligjor (*shih vendimin nr. 122, datë 25.10.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

23. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 18.4.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datë 14.8.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

24. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 3, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit, në thelb, kanë të bëjnë me disponimin e vendimit që ka vendosur ndaj tij dënimin me gjobë në masën 10,000 lekë, në cilësinë e përfaqësuesit të palës në gjykim, disponim i cili, sikurse u theksua më lart, është ngushtësisht i lidhur me disponimin parësor, atë të mospranimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Kërkuesi i ka lidhur pretendimet e tij me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar, gjithashtu, se këto vendime i kanë mohuar edhe disa të drejta të tjera, si ajo e jetës, e punës, e arsimit dhe për siguri juridike.

26. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*) kur ka shqyrtuar raste të kësaj natyre ka analizuar zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së për sa i përket aspektit civil ose penal. Sipas GJEDNJ-së vendosja e gjobave për abuzimin e së drejtës për të paraqitur kërkesë është një masë procedurale që gjykata mund të marrë gjatë procesit që zhvillohet para saj, por ajo nuk përfshin një ndalim të përgjithshëm për përfaqësimin e klientëve përpara gjykatave të tjera. Vendosja e gjobave nuk mund të konsiderohet se përcakton të drejtën civile të kërkuesit për të ushtruar profesionin e avokatit. Për sa i përket reputacionit, GJEDNJ-ja ka konstatuar se procesi gjyqësor në raste të tilla nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me reputacionin profesional të avokatit, por me çështjen nëse ka abuzim me të drejtën e paraqitjes së kërkesës prej tij në gjykatë. Prandaj, çështja e reputacionit është një nga pasojat e mundshme të konstatimit nëse ka pasur një abuzim të së drejtës së paraqitjes së kërkesës prej avokatit. Për sa u përket gjobave të vendosura ndaj palëve në proceset gjyqësore për abuzim të procesit ose kundërshtim të gjyqtarit, ajo gjykatë ka vlerësuar se ato synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe, për rrjedhojë, kanë karakteristikat e sanksioneve procedurale që nuk përcaktojnë të drejta ose detyrime civile (*shih Žugić kundër Kroacisë, nr. 3699/08, datë 31.5.2011, § 63).*

27. Lidhur me gjobat në fjalë, GJEDNJ-ja është shprehur se pasojat e pashmangshme monetare të tyre, shumat e të cilave nuk janë të larta, nuk janë në vetvete të mjaftueshme për zbatueshmërinë e aspektit civil të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Adil Aktay kundër Turqisë, datë 9.1.2024, § 45*). Gjithashtu, po sipas GJEDNJ-së, parashikimet ligjore që u mundësojnë gjykatave të zakonshme të reagojnë ndaj sjelljeve jokorrekte të avokatëve në proceset gjyqësore kanë qëllimin që të sigurojnë funksionimin e duhur dhe të rregullt të këtyre proceseve (*shih Gestur Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës [DhM], datë 22.12.2020, §§ 81 dhe 89*).

28. Nisur nga sa më lart, Gjykata rithekson se dispozita procedurale që parashikon caktimin e gjobës si një mjet të ri për disiplinimin e procesit gjyqësor, ka për qëllim shmangien e abuzimeve me të drejtat në procesin gjyqësor dhe i kundërdrejtohet palës ose përfaqësuesit të saj, kur me vetëdije paraqet kërkesa ose pretendime abuzive. Dhënia e vendimit për caktimin e gjobës ndaj palëve ndërgjyqëse ose përfaqësuesve të tyre është një masë procedurale që i shërben funksionimit të duhur të procesit të rregullt gjyqësor dhe mirëadministrimit të drejtësisë. Kjo do të thotë se gjoba e caktuar, në dallim nga gjoba administrative, ka regjim juridik të ndryshëm, pasi normohet nga një kuadër tjetër ligjor, jepet nga një organ gjyqësor dhe jo administrativ, si dhe ka për qëllim zhvillimin e procesit gjyqësor të themelit pa abuzim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimin nr. 122, datë 25.10.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

29. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se caktimi i gjobës ndaj kërkuesit ka qenë një masë procedurale që është vendosur në zbatim dhe përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, e lidhur me ushtrimin e kompetencës së gjykatës për të siguruar zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor dhe konkretisht për të ndaluar abuzimin me ushtrimin e të drejtave gjatë procesit penal në të cilin kërkuesi ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor. Për më tepër, nuk është provuar nga kërkuesi se masa e gjobës ka përcaktuar të drejta ose detyrime civile ndaj tij ose ka ndikuar në reputacionin e tij. Për rrjedhojë, bazuar në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, natyrën e gjobës, qëllimin për të cilin ajo është vendosur, dhe kryesisht masën e saj, Gjykata në të njëjtën linjë me qëndrimin e GJEDNJ-së vlerëson se ajo nuk prek ose ndërhyn në të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Prandaj vendimi që ka caktuar gjobën ndaj kërkuesit nuk hyn në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe pretendimet e tij nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata. Për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materia* në lidhje me kërkimet e tij.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 4.4.2024.
Shpallur, më 30.4.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahimi
Anëtare kundër: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Ahmet Jangulli, me objekt: *"Shfuqizimi i vendimeve penale për "disponimin ndëshkues ndaj avokatit", nr. 115, datë 9.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 638, datë 5.7.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-649, datë 18.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë",* kam qëndrim të kundërt me shumicën ndaj dhe do të paraqes argumentet kushtetuese në vijim.

2. Në ndryshim nga shumica, e cila ka vendosur moslegjitimimin *ratione materie* të kërkuesit e për rrjedhojë nuk ka vijuar me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tij, vlerësoj se kërkuesi ka ngritur para Gjykatës pretendime me natyrë kushtetuese dhe në lidhje me to ka provuar edhe pasojat e ardhura në këto të drejta për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar. Në këtë drejtim nuk pajtohem me qëndrimin e saj për moslegjitimimin *ratione materiae*, duke u mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, me qëllim kufizimin e aksesit kushtetues të individit. Konkretisht, sipas saj, caktimi i gjobës ndaj kërkuesit ka qenë një masë procedurale që është vendosur në zbatim dhe përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, e lidhur me ushtrimin e kompetencës së gjykatës për të siguruar zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor dhe konkretisht për të ndaluar abuzimin me ushtrimin e të drejtave gjatë procesit

penal në të cilin kërkuesi ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor. Për më tepër, nuk është provuar nga kërkuesi se masa e gjobës ka përcaktuar të drejta ose detyrime civile ndaj tij apo ka ndikuar në reputacionin e tij. Për rrjedhojë, bazuar në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, natyrën e gjobës, qëllimit për të cilin ajo është vendosur, dhe kryesisht në masën e saj, Gjykata në të njëjtën linjë me qëndrimin e GJEDNJ-së vlerëson se ajo nuk prek apo ndërhyn në të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Prandaj vendimi që ka caktuar gjobën ndaj kërkuesit nuk hyn në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe pretendimet e tij nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

3. Ashtu sikundër ka theksuar Gjykata në jurisprudencën e saj, Kushtetuta nëpërmjet referimit te KEDNJ-ja i ka dhënë këtij dokumenti vlerën e standardit kushtetues për sa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut. Ligjvënësi nuk mund të vendosë kufizime që tejkalojnë ato të parashikuara nga KEDNJ-ja, por ai nuk pengohet që nëpërmjet legjislacionit të zgjerojë hapësirën e të drejtave dhe lirive dhe t'i japë një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit *(shih vendimet nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 24, datë 13.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Edhe sipas nenit 53 të KEDNJ-së, asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose cenon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo pale të lartë kontraktuese ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo palë e lartë kontraktuese është palë. Po në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se në lidhje me një të drejtë themelore, respektimi i detyrimeve ndërkombëtare nuk mundet asnjëherë të jetë shkak i një zvogëlimi të mbrojtjes së saj në krahasim me ato të parashikuara tashmë nga rendi i brendshëm, por mund dhe duhet, përkundrazi, të përbëjë instrument efikas të zgjerimit të vetë mbrojtjes *(shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

4. Për sa më sipër, Kushtetuta ka përcaktuar një standard edhe më të lartë se GJEDNJ-ja lidhur me garancitë dhe të drejtat themelore të individit, ndaj dhe jurisprudenca e GJEDNJ -së nuk mund të përdoret si argument për ngushtimin e garancive kushtetuese. Ky qëndrim është në konsistencë edhe me qëndrimin në dy çështje të tjera, të ngjashme, përkatësisht me vendimet nr. 64/2021 dhe nr. 122/2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, në të cilat kam votuar për shterimin e mjeteve juridike efektive si kriter i plotësuar, si dhe për legjitimimin *ratione materiae* në raport me pretendimet, si test që duhet kaluar për shqyrtimin në themel të ankimit individual kushtetues.

5. Duke iu kthyer rrethanave të çështjes, në rastin konkret procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka të bëjë me kundërshtimin e masës së gjobës së vendosur ndaj tij nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila ka vlerësuar se ai ka abuzuar me të drejtat në proces, për shkak se ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares që po gjykonte çështjen penale konkrete, ku ai ishte përfaqësues ligjor i kallëzuesit A.B.

6. Konkretisht, me vendimin nr. 115, datë 9.7.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka vendosur me vendim të ndërmjetëm rrëzimin e kërkesës për përjashtim, si edhe vendosjen e masës së gjobës ndaj kërkuesit, në mënyrë nominale, në vlerën 10,000 lekë. Edhe pse në dispozitiv gjykata ka disponuar se kundër këtij vendimi lejohet ankim së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi për mospranimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit dhe caktimin e gjobës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 638, datë 5.7.2022, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk mund të ankimohet me ankim të veçantë, por vetëm së bashku me vendimin përfundimtar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se ankimi i veçantë është paraqitur vetëm ndaj vendimit nr. 115, datë 9.7.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërkohë që nuk ka pasur ende një vendim përfundimtar për themelin e çështjes penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kallëzuesi A.B., nëpërmjet avokatit Ahmet Jangulli, duke kërkuar prishjen e tij dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

7. Me vendimin nr. 00-2023-649, datë 18.4.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se vendimi që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit dhe caktimin e gjobës është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim i veçantë, por mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar për

themelin e çështjes. Sipas këtij Kolegji, ky parashikim është shprehur qartë në fjalinë e dytë të nenit 22, pika 4, të KPP-së në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës për përjashtim. Më tej, Kolegji Penal ka arsyetuar se nga interpretimi literal i nenit 22/a të KPP-së, sanksioni i parashikuar në këtë nen është pjesë e vendimit që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit dhe në interpretim sistematik të tij, e drejta e ankimit e parashikuar në nenin 22, pika 4, të KPP-së, sipas të cilit kundër vendimit të përjashtimit mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, vlen për të gjithë vendimin në tërësi, pra edhe për atë pjesë të tij që përmban parashikimin e sanksionit "gjobë" *(shih paragrafin 21 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

8. Për sa më lart, thelbi i procesit kushtetues në shqyrtim nga Gjykata dhe i vetë kërkesës së kërkuesit ka qenë cenimi i së drejtës së aksesit, të ankimit dhe asaj për t'u dëgjuar për sa kohë kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e tij nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me masën e gjobës. Në këtë drejtim ai ka pretenduar edhe cenimin e standardit të arsyetimit për shkak të mënyrës se si e kanë trajtuar ankimin e tij gjykatat e zakonshme dhe për shkak se nuk kanë analizuar se çfarë konsiderohet ankim i veçantë.

9. Në lidhje me aksesin, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Ndërsa neni 43 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Në lidhje me këtë të drejtë Gjykata është shprehur se rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës (*shih vendimin nr. 9, datë 23.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në analizë të legjislacionit procedural, KPP-ja, neni 22, pika 4, ka parashikuar se kundër vendimit për përjashtimin e gjyqtarit mund të bëhet ankim i veçantë së bashku me vendimin përfundimtar. Kësaj dispozite i ka dhënë kuptimin ligjor Gjykata e Lartë në rastin konkret, si dispozitë e cila përthith edhe ankimin ndaj vendimit të gjobës si sanksion, parashikuar në nenin 22/a të KPP - së, i cili duhet ankimuar së bashku me vendimin përfundimtar. Megjithatë, gjykimi kushtetues ka për qëllim kontrollin nëse vetë përmbajtja ose interpretimi i ligjit ka sjellë pasoja antikushtetuese dhe mes disa mënyrave interpretimi a është zgjedhur interpretimi më pajtues nga gjykatat e zakonshme në kuptim të pasojave që sjell ky interpretim. Ky standard është theksuar ndër vite nga Gjykata, sipas së cilës mes disa lloj interpretimeve gjykatat kanë detyrë të zgjedhin interpretimin që passjell rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Në rastin konkret, ashtu siç edhe është arsyetuar në lidhje me legjitimimin *ratione personae* në vendim*,* për sa kohë që gjoba është dhënë nominalisht ndaj avokatit, dispozitat procedurale vënë në dyshim respektimin e së drejtës së kërkuesit për të pasur një rishikim të këtij vendimi në një gjykatë më të lartë. Në këtë aspekt, për sa kohë që kërkuesi nuk është më as përfaqësues ligjor i kallëzuesit A.B., në situatën që gjykata ka vendosur edhe përjashtimin e tij si avokat nga gjykimi, nuk duket se

mjetet procedurale garantojnë për të një mjet ankimi efektiv, në drejtim të ankueshmërisë së gjobës. Kallëzuesi vetë ose përfaqësuesi ligjor i ri i tij, nga njëra anë, nuk ka interes për kundërshtimin e një vendimi që nuk ka dhënë ndaj tij masën e gjobës, ashtu sikundër kërkuesi, nga ana tjetër, nuk mund të kundërshtojë vendimin përfundimtar në të cilin nuk është palë së bashku me vendimin e ndërmjetëm të gjobës.

13. Për sa më lart, vlerësoj se Gjykata e Lartë, përmes arsyetimit të saj se vendimi i gjykatës së shkallës së parë për përjashtimin e gjyqtarit është një vendim ndaj të cilit nuk mund të lejohet ankim i veçantë, por mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar, pra edhe për atë pjesë të tij që përmban parashikimin e sanksionit "gjobë" *(shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë),* duket se i ka mohuar të drejtën për akses substancial dhe ankim efektiv kërkuesit ndaj kontrollit gjyqësor për bazueshmërinë e vënies së gjobës, duke mos i interpretuar dispozitat procedurale në atë mënyrë që të ofronin një mbrojtje kushtetuese të të drejtave të individit. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Për më tepër, vlerësoj se ky qëndrim imi mbi themelin është në koherencë edhe me qëndrimin mbi legjitimimin tek kriteri i shterimit, ku kemi pranuar se për qëllimet e analizës së kriterit të shterimit të mjeteve juridike për sa kohë që vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit, është kundërshtuar në shkallët më të larta dhe ka një masë autonomie nga procesi i themelit, përjashtimi i tij nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të së drejtës për ankim kushtetues subastancial. (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Ndaj për rrjedhojë, për të njëjtat argumente nga pikëpamja logjike dhe juridike, çmoj se do të duhej të konstatohej cenim i së drejtës së kërkuesit për akses substancial për ankueshmërinë e gjobës nga Gjykata e Lartë.

15. Si konkluzion, vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, do të duhej të shfuqizohej, pasi ka cenuar të drejtën e aksesit substancial dhe të ankimit efektiv të kërkuesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, për rrjedhojë kërkesa duhej pranuar pjesërisht.

Anëtar: **Elsa Toska**